

UDHËZIM
Nr. 6, datë 11.12.2000

PËR CAKTIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE ORGANIKËS SË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT

Me përfundimin e konstituimit të këshillave të qarqeve për hartimin e strukturës organizative dhe organikës së administratës së këshillit të qarkut, në mbështetje të nenin 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës, nenit 74 pika 1, nenit 75 dhe nenit 54 pika “d” të ligjit nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,

U D H Ë Z O J:

- Se miratimi i strukturës organizative dhe organikës së administratës së këshillit të qarkut është kompetencë e këshillit të qarkut.
- Për realizimin e kësaj kompetence të ndiqet kjo procedurë:
 1. Ministria e Pushtetit Lokal, në mbështetje të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të nenit 5 të ligjit nr.7776 datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, me ndryshime nga Ministria e Financave, çel llogarinë e këshillit të qarkut dhe i dërgon atij treguesin e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore, si dhe strukturën orientuese (bashkëlidhur) që i rekomandohet këshillit të qarkut për ndërtimin e administratës së vet.
 2. Mbështetur në këta tregues, mundësitë që ka vetë këshilli i qarkut që nga të ardhurat e veta të përdorë një pjesë të tyre për këtë qëllim, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore” me ndryshimet përkatëse, kryetari i këshillit të qarkut në bashkëpunim me zëvendëskryetarin e këshillit, hartojnë projekt-strukturën organizative, organikën me emërtimin e detyrave sipas klasave që përcaktojnë pagën bazë mujore dhe shtesën për funksion; pasi e shqyrton këtë material në kryesinë e këshillit të qarkut, ia paraqet për miratim këshillit të qarkut.
 3. Mbështetur në vendimin e këshillit të qarkut, si dhe në zbatim të nenit 60 pika “dh” të ligjit nr.8652 datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” kryetari emëron personelin e administratës, i cili për realizimin e kësaj detyre duhet të mbajë parasysh:
 - Sipas ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, kreu III, përcaktohen vendet e punës që trajtohen sipas këtij ligji dhe emërimi i këtyre nëpunësve do të bëhet sipas kërkesave të nenit 10 të ligjit si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.231 datë 11.5.2000 “Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës”.
 - Në administratën e këshillit të qarkut, të tërhiqen për sa është e mundur nëpunës të specializuar dhe me përvojë të gjatë pune në administratën e pushtetit vendor. Në mënyrë të veçantë nga administratat e këshillave të rretheve të cilat suprimohen, ky kontigjent duhet të trajtohet sipas kërkesave të ligjit “Statusi i nëpunësit civil”, kreu i IV, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.342, datë 7.7.2000 “Për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të nëpunësve civilë”.
 - Punonjësit e tjerë që nuk i nënshtrohen kërkesave të ligjit të sipërpërmendur emërohen direkt nga kryetari.
 4. Urdhërat e kryetarit për emërimin e punonjësve si gjithë aktet e këshillit (vendimet dhe urdhëresat) brenda 7 ditësh nga dita e miratimit të tyre i dërgohen prefektit, i cili brenda 10 ditësh duhet të shprehet për ligjshmërinë e aktit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUSHTETIT LOKAL
Bashkim Fino

STRUKTURA ORIENTUESE E APARATIT ADMINISTRATIV
TË KËSHILLIT TË QARKUT

Nr.	NJËSIA STRUKTURORE	NR.PUNONJËSVE
1.	Kryetar	1
2.	Sekretar i kryetarit	1
3.	Zëvendëskryetar (qenia funksionar fakultative)	1
4.	Sekretar i Këshillit të qarkut	1
5.	Seksioni i prog. dhe Zhvillimit Rajonal	5
	Përgjegjës	1
	Sektori i programimit	2
	Sektori i zhvillimit (investimeve)	2
6.	Seksioni i shërbimeve rajonale	4
	Përgjegjës	1
	Specialiste	3
7.	Seksioni i Urbanistikës	5
	Përgjegjës	1
	Specialist	4
8.	Seksioni i financës	3
	Përgjegjës	1
	Specialist	2
9.	Seksioni juridik dhe i marrëdhënieve me jashtë	3
	Përgjegjës	1
	Specialist	2
10.	Seksioni i personelit dhe i shërbimeve	10
	Përgjegjës	1
	Specialist	1
	Operator	1
	Protokoll-arkive	1
	Shoferë	3
	Pastruese	1
	Magaznier	1
	Roje operative	1
11.	Zyra e emergjencave civile	1
Numri i Përgjithshëm		35

